

Informacion përmbledhës mbi projektet me financim nga donatorë të huaj dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare

❖ Titulli i projektit: “Projekt i Shërbimeve Mjedisore”

Financuesi: IBRD,GEF,SIDA,MM
Kosto totale: 16,815 Mil Euro
Kohëzgjatja: Janar 2015-Dhjetor 2019

Objektivi i projektit të Shërbimeve Mjedisore (ESP) është të mbështesë praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe rritja e përfitimeve monetare dhe jo-monetare për komunitetet në zona të caktuara të Projektit, të cilat shtrihen kryesisht në zonat të ngritura rurale të prekshme nga erozioni.

Komponentët e Projektit:

- Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peisazhit që përfshin:
 - (i) përgatitjen e një Inventari Kombëtar të Pyjeve;
 - (ii) krijimin e Sistemit shqiptar të Informimit për Pyjet;
 - (iii) regjistrimin e pyjeve dhe kullotave që i janë transferuar komunave nga qeveria qendrore;
- Planifikimi dhe Ofrimi i Nëngranteve për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës që përfshin realizimin e aktiviteteve për të përgatitur dhe zbatuar Planet Komunale për Mikrobaset për përmirësimin e menaxhimit të tokës dhe dhënien e Granteve për përfituesit që plotësojnë kriteret (Individët, Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale);
- Prezantimi i Pagesave për Shërbimet Mjedisore nëpërmjet përgatitjes së studimeve teknike për zhvillimin e projekteve të karbonit dhe zhvillimit të mekanizmave për Pagimin e Shërbimeve të Ujëmbledhësit për t'u siguruar se ata që përfitojnë nga shërbimet mjedisore i paguajnë prodhuesit e këtyre shërbimeve; dhe zhvillimin e një modeli për lidhjen e praktikave të përdorimit të tokës me gjenerimin e shërbimeve të ekosistemit.
- Mbështetja për Zbatimin e Projektit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve duke përfshirë furnizimin me pajisje zyre, ndërtimin e kapaciteteve të stafit dhe zbatimin e garancive mjedisore.

❖ **Titulli i projektit: “Forcimi i kapaciteteve kombëtare për ruajtjen e Natyrës - NATURA 2000”- IPA 2013**

Financuesi: Bashkimi Evropian, MM
Kosto totale: 4,4 milion Euro
Kohëzgjatja: 2015-2017

Objektivi i projektit: Synon ndalimin dëmeve dhe humbjen e Biodiversitetit në Shqipëri, nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura në vend.

Komponentët e projektit janë:

- a. Implementimi i të paktën 5 Planeve ekzistuese të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura.
- b. Përgatitja e një liste paraprake të vendeve të mundshme për rrjetin Natura 2000 për të gjithë vendin.
- c. Inventar on-site.
- d. Hartimi i fishave të projekteve për fushën e biodiversitetit.

❖ **Titulli i projektit: “Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën- IBECA”- IPA 2013**

Financuesi: Bashkimi Evropian, MM
Kosto totale: 1,789,000 Euro
Kohëzgjatja: 2015-2017

Objektivi i projektit: Të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit përmes kërkesave dhe menaxhimit më të mirë të mjedisit dhe klimës duke bërë të mundur që institucionet shtetërore të zhvillojnë, zbatojnë dhe detyrojnë standardet e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën.

Komponentët e projektit janë:

- Komponenti A: Rritja e efektivitetit të strategjisë së mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike përmes hartimit dhe zbatimit të planit sektorial dhe transpozimit dhe zbatimit të akteve prioritare të legjislacionit evropian për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.
- Komponenti B: Përmirësimi i inspektimit, detyrimit dhe ndjekjes penalisht të shkeljeve të legjislacionit për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.
- Komponenti C: Përmirësimi i menaxhimit të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në nivel qendror e lokal.

❖ **Titulli i projektit: “Asistencë teknike në fushën e mbetjeve IPA 2013”**

Financuesi: Bashkimi Evropian, MM
Kosto totale: 2,2 milion Euro
Kohëzgjatja: 2016-2019

Objektivi i projektit: është të kontribuojë për menaxhim më të mirë të integruar të mbetjeve. Për këtë projekt janë parashikuar dy studime fizibiliteti për Durrësin dhe Fierin. Objektivi i përgjithshëm është për të zhvilluar një mjedis më të pastër dhe më të sigurt për qytetarët në Shqipëri.

Outputi i këtij projekti:

Përsa i përket produktit dhe outputit të tij pritet të ofrojë Asistencë teknike për disa rajone në lidhje me studime fisibiliteti në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

❖ **Titulli i projektit: “Rishikimi dhe Përditësimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Konventën e Stokholmit, mbi Ndotësit Organik të Qëndrueshëm (NOQ) në Shqipëri**

Financuesi: UNEP, GEF,MM
Kosto totale: 406,046 USD
Kohëzgjatja: Qershor 2014-Maj 2017

Objektivi kryesor: Përmbyshja e detyrimeve që rrjedhin nga Neni 7, i Konventës, për përditësimin e PKV për NOQ: *“Vendet anëtare duhet të rishikojnë dhe përditësojnë, në mënyrën më të mirë, planin e zbatimit në mënyrë periodike dhe në mënyrën e përcaktuar sipas vendimit të COP”*;

Objektiva të tjerë: Të rrisë kapacitetet mbi përditësimin e PKV në vend, si dhe të forcojë koordinimin institucional në nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar.

Komponentët e projektit janë:

- Komponenti 1: Fillimi i procesit të rishikimit dhe përditësimit të Planit Kombëtar të Veprimit;
- Komponenti 2: Vlerësimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve kombëtare për menaxhimin e të gjitha NOQ, përgatitjen e inventareve të NOQ të rinj dhe rishikimi i inventarëve fillestare të NOQ dhe monitorimi i ndikimit të NOQ në shëndet dhe mjedis;
- Komponenti 3: Përgatitja e Masave të Veprimit për NOQ e rinj dhe përditësimi i Masave të veprimit për 12 NOQ e para, përfshirë analizën e boshllëqeve;

- Komponenti 4: Përgatitja e PKV të rishikuar dhe përditësuar me masat shoqëruese të veprimit për 23 NOQ;
- Komponenti 5: Dorëzimi i PKV në Sekretariatit e Konventës.

❖ **Titulli i projektit: “Mbështetja e reduktimit të mbetjeve dhe promovimi i konceptit 3R në Republikën e Shqipërisë”**

Financuesi: JICA
 Kosto totale: 1,574,000 Euro
 Kohëzgjatja: 2014- 2017

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është që korniza 3R të hyjë në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta për pushtetin vendor në Shqipëri për reduktimin e mbeturinave, si një përpjekje mbarëkombëtare.

Qëllimi i projektit është që kapacitetet e Ministrisë së Mjedisit të forcohen në kuptim të zhvillimit të politikës 3R si dhe të ofrimit të mbështetjes për qeveritë lokale për të zbatuar *Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve* dhe *Planin Veprues* në Shqipëri.

❖ **Titulli i projektit: “Ruajtja dhe Përdorimi i Qëndrueshëm i Biodiversitetit në Liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës (Plan Rajonal për Shqipërinë Maqedoninë dhe Malin e Zi)-CSBL II”**

Financuesi: GIZ Gjerman;
 Kosto totale: 2 Mln Euro.
 Kohëzgjatja: 2014 – 2017

Objektivi i përgjithshëm është: Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit, rregulloreve dhe planeve të menaxhimit për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit në liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës në përputhje me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe të biodiversitetit të BE-së. Fokusi kryesor i masave janë aktivitetet e menaxhimit të burimeve ujore dhe peshkimit të qëndrueshëm, ndërsa ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike është themeluar kryesisht si një çështje ndërsektoriale.

Projekti do të përfshijë 4 fusha kryesore:

1. Bashkëpunimin Transnacional;
2. Ruajtjen e biodiversitetit;
3. Peshkimin e Qëndrueshëm dhe

4. Menaxhimit e Burimeve Ujore.

❖ **Titulli i projektit: “Drejt qeverisjes së sforcuar të trashëgimisë së përbashkët natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të liqenit të Ohrit”**

Financuesi: Bashkimi Evropian, MM
Kosto totale: 1,870,000 Euro
Kohëzgjatja: 2014-2017

Objektivi i projektit është: Të përforcojë strukturat e menaxhimit të rajonit ndërkufitar të liqenit të Ohrit në funksion të një njohje të mundshme të gjithë zonës kulturore dhe natyrore të Liqenit, si pronë të Trashëgimisë Botërore.

Projekti ka tre komponentë si më poshtë:

- (i) Forcimin e platformës së bashkëpunimit ndërkufitar për Liqenin e Ohrit dhe rritjen e mundësive për turizëm;
- (ii) Zbatimin e fushatës për mbetjet përmes aktiviteteve pilot;
- (iii) Njohjen e procesit për të gjithë zonën e Liqenit si pronë e Trashëgimisë Botërore.

❖ **Titulli i Projektit: “Biosfera e Rezervatit të Prespës (II)”**

Financuesi: Qeveria Gjermane, Banka KfW, MM
Kosto totale: 3,5 MI Euro
Kohëzgjatja: 2016 - 2020

Objektivi i Projektit: Është që të reduktojë presionin mbi burimet natyrore si edhe uljen e varfërisë në pjesën e Shqipërisë të Rezervës së Biosferës, Prespë. Kjo do të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës të popullsisë në PNP dhe në pjesën shqiptare të Rezervës së Biosferës

Komponentët e projektit janë:

- i) Fillimin e aktivitetit të Biosferës Rezervë së miratur nga UNESCO;
- ii) Konsolidimi i aktiviteteve social - ekonomike,
- iii) Përmirësimi i mbrojtjes së aseteve të biodiversitetit në Parkun Kombëtar të Prespës;
- iv) Marrjen e masave për zbutjen e presionit dhe mitigimin e përdorimit pa kriter të tokës në Parkun Kombëtar të Prespës;
- v) Menaxhimi i projektit.

❖ Titulli i projektit: “Transformimi i tregut dhe fuqizimi i iniciatives për përdorimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë në Shqipëri”

Financuesi: GEF/UNDP/ MEI/ MM.
Kosto totale: 2,105,000 USD;
Kohëzgjatja: 2010 -2016

Objektivi kryesor i këtij projekti është përkrahja dhe miratimi i energjisë diellore si një nga burimet më të fuqishme të energjive të rinovueshme në Shqipëri, nëpërmjet menjanimit të pengesave dhe reduktimit të kostos së zbatimit.

Aktivitetet kryesore të projektit janë:

1. Krijimi i një kuadri ligjor, rregullator dhe institucional për të promovuar një treg të qendrueshëm për panele diellore për ujë të ngrohtë (Solar Water Heating/SWH);
2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe e kapaciteteve të përdoruesve fundor dhe furnizuesve për SWH;
3. Rritje e kërkesës për SWH përmes aplikimit të një mekanizmi të përshtatshëm financiar dhe modele të tjera të tilla si SESCO;
4. Aplikimi i një skeme të përshtatshme për Shqipërinë për certifikimin dhe kontrollin e paneleve diellore SWH dhe rritja e ndërgjegjësimit të furnizuesve të këtyre sistemeve me qëllim promovimin e një tregu të qëndrueshëm të SWH.

❖ Titulli i projektit: “Përmirësimi i mbulimit dhe efikasitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare”

Financuesi: GEF/UNDP, MM
Kosto totale: 2,927,500 USD;
Kohëzgjatja: 2011 - 2016

Objektivi kryesor i këtij projekti është të përmirësojë efektivitetin e mbulimit dhe menaxhimit të rrjetit të Shqipërisë për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare, si një aspekt plotësues thelbësor për rrjetin e zonave të mbrojtura tokësore.

Komponentët e projektit janë:

1. Përmirësimi i përfaqësimit bio-gjeografik i Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (ZMDB), dhe

2. Përmirësimi i menaxhimit të ZMDB duke qartësuar kuadrin institucional si dhe ngritjen e kapaciteteve.

Aktivitetet e projektit janë:

- 1 Hartimi i Strategjisë së Planit të Veprimit për Zonat e Mbrojtura Detare (PSZMDBS); e cila është pjesë e Strategjisë së përditësuar të Biodiversitetit
- 2 Fushatat e informimit, komunikimit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e vlerave dhe nevojave për mbrojtjen e ZMDB në Shqipëri.

❖ **Titulli i projektit: “Komunikimi i tretë Kombëtar”**

Financuesi: GEF,MM
Kosto totale: 480, 000 USD
Kohëzgjatja: 2012 – 2016

Objektivi kryesor i projektit është përditësimi vjetor i Inventarit të Gazeve serë antropogjene për periudhën 2000 -2005, e cila do të përdoret për të zhvilluar një Strategji kombëtare për uljen e karbonit.

Komponentët e projektit janë:

1. Vlerësimin e rrethanave kombëtare dhe masat e marra për të zbatuar KKKBNK në Shqipëri;
2. Inventarin kombëtar për gazet serë për periudhën 2000 -2005;
3. Ndryshimet klimatike dhe vlerësimi i prekshmërisë;
4. Analizat për zbutjen e gazeve serë;
5. Publikimin dhe pormovimin i Komunikimit të tretë kombëtar të përgatitur.

❖ **Titulli i Projektit: “Mbrojtja dhe përmirësimi i menaxhimit të integruar të mjedisit detar dhe ndërkufitar të burimeve natyrore - ECOSEA”**

Financuesi: Bashkimi Evropian- IPA Adriatic, MM
Kosto totale projekti: 3.757.555 €
Kosto totale- Shqipëria: 250.470 €.
Kohëzgjatja: 2012 - 2016

Objektivi kryesor i projektit është të promovojë përmirësimin e ekosistemeve detare dhe bregdetare duke propozuar modele për një menaxhim të koordinuar të peshkimit, me aktivitete direkte për të përmirësuar qëndrueshmërinë e peshkimit dhe forcimin e biodiversitetit detar. Ky projekt ka 9 partnerë, respektivisht 6 rajone italiane, 2 kroate dhe Ministrinë e Mjedisit.

Ndërkohë, në kuadër të aktiviteteve të projektit, çdo partner punon për Paketën e Punës, për të cilën janë lider për detajimin e planit të aktiviteteve. Ministria e Mjedisit e Shqipërisë është lider për paketën e punës për: (I) Forcimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit të detit Adriatik;

❖ **Titulli i projektit: “Ruajtja dhe Përdorimi i Biodiversitetit në zonat rurale në Shqipëri-CABRA II”**

Financuesi: GIZ Gjerman;
Kosto totale: 2 Mln Euro
Kohëzgjatja: 2015 – 2017

Objektivi i përgjithshëm është: Fokusi kryesor i projektit është mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit dhe agrobiodiversitetit në zonat e përzgjedhura malore të Shqipërisë (kryesisht rajoni i Alpeve).

Komponente kryesore të projektit:

1. Mbrojtja biodiversitetit dhe agrobiodiversitetit;
2. Rritja e të ardhurave në familjet rurale nëpërmjet përdorimit të balancuar, të qëndrueshëm dhe në balancë gjinore të burimeve natyrore;
3. Aplikimi i instrumenteve të rinj të politikave, procedurave dhe proceseve për mbrojtjen e biodiversitetit.

❖ **Titulli i projektit: “Adaptimi ndaj Ndryshimeve Klimatike në Ballkanin Perëndimor CCAWB**

Financuesi: Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim BMZ
Kosto totale: 3,5 milion Euro
Kohëzgjatja: Janar 2012 – Dhjetor 2018

Objektivi kryesor i këtij projekti është të mbështesë pesë vendet perkatësisht Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Kosovën dhe Serbinë në pesë komponentë të përcaktuara në zhvillimin e kapaciteteve, shërbimeve këshillimore dhe prokurim pajisjesh.

Komponentët e projektit janë:

1. Ngritja e një sistemi rajonal për parashikimin e hershëm të përmbytjeve në basenin e Drinit;
2. Hartimi i strategjive kombëtare për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
3. Formulimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të përmbytjeve dhe thatësirave në nivel komunash;
4. Bashkëpunim rajonal për menaxhimin e burimeve të integruara të ujit (IWRM).
5. Integrimi i strategjive për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin urban.

❖ **Titulli i projektit: Krijimi i sistemit të menaxhimit dhe monitorimit mjedisor në linjë me raportimet globale**

Financuesi: GEF/UNDP/MM
Kosto totale: 1,120,000 USD
Kohëzgjatja: Nëntor 2015- Nëntor 2019

Objektivi kryesor i këtij projekti është të adresojë nevojën për një sistem të monitorimit të mjedisit të integruar në të gjithë institucionet relevante qeveritare dhe që përdor standardet ndërkombëtare të monitorimit për mbledhjen e të dhënave, analizimin e tyre, dhe politikëbërjen në bazë të të dhënave.

Ai do të përmirësojë kapacitetet ekzistuese teknike dhe institucionale në Shqipëri për të monitoruar dhe raportuar në konventat e Rio – CBD, UNCCD, UNFCCC.

Komponentët e projektit janë:

- Komponenti 1- Adresimi për një zgjidhje institucionale dhe IT për një monitorim të Integruar të Informacionit Mjedisor dhe Sistemit të Menaxhimit (EIMMS).
- Komponenti 2- Përditësimi i treguesve, bazës së të dhënave dhe synimeve.
- Komponenti 3- Ngritja e kapaciteteve për përdorimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit.

❖ **Titulli i projektit: “Arritja e përshtatjes së Lagunës Kune-Vaini përmes përqasjes së adaptimit të bazuar në Ekosistem” (EbA)**

Financuesi: UNEP/GEF
Kosto totale: 1,903,000 US \$

Kohëzgjatja: 2016-2019

Objektivi kryesor projektit është të synojë forcimin e kapaciteteve qendrore dhe lokale për menaxhim sa më të mirë të laguneës së Kune-Vainit duke marrë në konsideratë ndikimin e ndryshimeve klimatike, problemet e erozionit, rreziqet ndaj faunës dhe florës. Gjithashtu synon zhvillimin e disa masave të bazuara në ekosistem në lagunë.

Komponentët e projektit janë:

- Kapacitetet teknike dhe institucionale për të adresuar rreziqet e ndryshimeve klimatike përmes adaptimit në ekosistem (EBA);
- Ndërhyrje konkrete në lagunë për të bërë të mundur:
 1. Reduktimin e sedimentit,
 2. Rehabilitimin e dunave,
 3. Parandalimin e përmytjeve,
 4. Mbrojtjen dhe restaurimin e pellgut.
- Ndërgjegjësimi dhe njohja me vlerat e sistemit të Adaptimit të bazuar në Ekosistem (EbA)